



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

Prilapje datë:	15-05	2018
Prilapje numër:		
Numër i regjistrimit:	1-660	30719
Emri i autorit:		



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lipjan, 15.05.2018

THIRRJE PUBLIKE për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve Kulturore dhe Rinore të regjistruara dhe të cilat ushtrojnë aktivitete Kulturore dhe Rinore në komunën e Lipjanit.

1. Komuna e Lipjanit u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës OJQ-ve që veprimtarinë e vet e zhvillojnë në Komunën e Lipjanit të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në *avancimin, afirmimin Kulturorë dhe Rinore në komunën e Lipjanit.*
2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte në lëmin kulturorë dhe rinorë dhe sipas fushave mbështetëse si në vijim:
 - a) Në fushën e Kulturës dhe Rinisë,
 - b) Në fushën e Inovacionit dhe Teknologjisë,
 - c) Në fushën e aktiviteteve të personave me nevoja të veçanta
 - d) Shoqatat e dalura nga Lufta.
3. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në **avancimin dhe fuqizimin e Kulturës dhe Rinisë në Komunën e Lipjanit.**
4. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 04.06.2018.
5. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje dhe vetëm në një (1) nga fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të projektit është për 6 muaj.
6. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Lipjanit para datës së publikimit të thirrjes publike. Organizatat e Shoqerisë

Civile aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e Kulturës dhe Rinisë. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Drejtoratit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-të duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ-të dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-të ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes <https://kk.rks-gov.net/lipjan/>

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen personalisht, në adresën e mëposhtme:

KOMUNA E LIPJANIT

Rruga „Shqipëria“

Zyra për shërbim të qytetarëve , nr 3,

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: agim.bylykbashi@hotmail.com, ose nr kontaktues 044/883-921, orari 08:00h -16:00h.

Kryetari i Komunës së Lipjanit

z. Imri AHMETI

